

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES-VLADA ROKOVA- GOVORNO SPOBNA
 MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY
 SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njesia Org. _____
 Org. Jedinica 2
 Org. Unit _____
 Nr. i faqeve _____
 Br. stranica 4
 No. pages _____

Nr. Prot. _____
 Brej Prot. 1847
 Prot. No. _____
 Data: _____
 Datum 08.05.19
 Date: _____



Programi i Punës

Bashkëpunimi shkencor-teknologjik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”

Ky program promovon bashkëpunimin bilateral dhe atë rajonal, për kooperim të ngushtë në fushën e arsimit dhe shkencës.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), janë anagazhuar të ndërtojnë ura komunikimi mes komuniteteve kërkimore shkencore të dy vendeve, me qëllim promovimin e bashkëpunimit në kërkime shkencore dhe inovacion, mes të dy vendeve.

Gjatë takimit delegacioni i Republikës së Shqipërisë dhe delegacioni i Republikës së Kosovës ofruan informacione të vlefshme mbi politikat shkencore dhe kërkimore në vendet e tyre përkatëse dhe diskutuan për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore-shkencore.

Rezultati i Komisionit të përbashkët Shqipëri-Kosovë, ishte miratimi i një programi konkret pune për vitet 2019-2021, nëpërmjet të cilit do të ofrohet mbështetje financiare për projekte të

përbashkëta kërkimore-shkencore, të hartuara bashkarisht nga hulumtues/punëtorë shkencorë të Shqipërisë dhe Kosovës.

Palët u shprehën të bindura se zbatimi i këtij programi, përveç se do të ndihmojë në vendosjen dhe thellimin e marrëdhënieve midis institucioneve shkencore dhe hulumtuesve/punonjësve shkencorë të të dyja vendeve, do të bëjë të mundur që ata të shfrytëzojnë të gjitha dijet e tyre shkencore, në mënyrë sa më të frytshme në projekte rajonale dhe shumëpalëshe.

Në këtë këndvështrim, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet atyre projekteve që do të krijojnë kushte për pjesëmarrje në Programin Kuadër të BE-së për Kërkimin dhe Inovacionin.

Gjithashtu u ra dakord, për angazhim të përbashkët në zhvillimin e aktiviteteve në kornizën brenda komuniteteve kërkimore dhe të ndërtimit të kapaciteteve të Horizon 2020 dhe rrjeteve

Të dyja palët ranë dakord për nënshkrimin e Protokollit të Programit të Bashkëpunimit Bilateral, me qëllim zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe shkencës midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sipas palëve, thirrja e parë e bashkëpunimit bilateral tekniko- shkencor, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, do të shpallet brenda muajit maj të vitit 2019.

Palët përgjegjëse për zbatimin e kësaj thirrjeje për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, do të jetë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ndërsa për Qeverinë e Republikës së Kosovës, do të jetë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Departamentii Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë, Divizioni për Inovacion dhe Transfertë të Dijes.

Protokoli i Bashkëpunimit

Bashkëpunimi shkencor-teknologjik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës"

Ky protokoll promovon bashkëpunimin bilateral dhe atë rajonal, për kooperim të ngushtë në fushën e arsimit dhe shkencës.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), janë anagazhuar të ndërtojnë ura komunikimi mes komuniteteve kërkimore shkencore të dy vendeve, me qëllim promovimin e bashkëpunimit në kërkime shkencore dhe inovacion, mes të dyja vendeve.

Neni 1

Qëllimet e Programit

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është financimi i projekteve të përbashkëta kërkimore për të stimuluar bashkëpunimin ndërkombëtar kërkimor mes institucioneve kërkimore-shkencore dhe komuniteteve shkencore të të dyja vendeve.

Ky program synon gjithashtu sigurimin e një mundësie për hulumtuesit/punonjësit shkencorë për të bashkëpunuar në një mjedis ndërkombëtar dhe për të zhvilluar karrierën e tyre shkencore, sidomos për fazën e hershme, karrierën e mesme, si dhe hulumtuesit femra.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Thirrja është e hapur për të gjitha disiplinat shkencore dhe të gjitha fushat tematike.

Neni 3

Kohëzgjatja e projekteve

Projektet do të mbështeten financiarisht nga AKKSHI, si zbatuese e këtij Programi dhe MASHT për një periudhë dy vjeçare.

Neni 4

Kriteret e Aplikimit

Për Republikën e Shqipërisë:

Kërkuesit nga Shqipëria që marrin pjesë në këtë Program, duhet të jenë pjesë e një institucioni kërkimor, si hulumtues të hershëm ose të mesëm.

Të gjithë studiuesit duhet të bazohen në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”; Neni 24; 26; 93; 95.

Për Republikën e Kosovës: Në këtë program mund të marrin pjesë të gjitha institucionet kërkimore-shkencore publike dhe private që i plotësojnë kushtet në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore shkencore dt. 28 mars 2013 (gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013), Programit kombëtar për Shkencë si dhe legjislacionin në fuqi që rregullojnë fushën e arsimit të lartë dhe shkencës në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Vlerësimi i aplikimeve

Pas datës së mbylljes së thirrjes aplikimet do të vlerësohen nga ekspertet e fushave të ndryshme shkencore, në mënyrë të pavarur për secilin vend.

Për Shqipërinë kryerja e vlerësimeve do të bëhet nga ekspertët e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI, sipas kriterëve më poshtë:

- Rëndësia dhe vlera shkencore. (maksimumi 32 pikë)
- Qëndrimi i propozimit shkencor të projektit (maksimumi 15)
- Vlera e projektit në kuptim të origjinalitetit; inovacion dhe aplikim në të dy vendet (maksimumi 14)
- Metodologjia (maksimumi 10)
- Planifikimi dhe realizueshmëria (maksimumi 4)
- Buxheti (maksimumi 9)
- Përvojë dhe specializim i stafit në fushën e kërkimit të interesit (maksimumi 10)
- Vlerësimi i dokumenteve të kërkuara për aplikim (maksimumi 6)

Prioritet do t'u jepet hulumtueseve femra.

Për Kosovën: Vlerësimi i projekteve nga ana e Republikës së Kosovës do të bëhet nga Këshilli Shkencor i MASHT dhe nga këshillat shkencore të fushave, bazuar në LVKSh nr. 04/L-135 dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për financimin e projekteve shkencore, dhe sipas vlerësimit të kritereve më poshtë:

- Natyra e propozuar e aktivitetit/ objektivat
- Shtirja dhe cilësia e bashkëpunimit ndërinstitucional
- Kualifikimi dhe eksperiencia e ekipit të projektit
- Menaxhmenti i projektit
- Menaxhimi financiar i planifikuar
- Përfshirja e hulumtuesve të rinjë kosovar të involvuar në projekt/ përfitimi i tyre
- Tema ndërsektoriale
- Aktivitetet janë ndërdisiplinare
- Përmbledhja

Prioritet do t'u jepet hulumtueseve femra.

Në përfundim të vlerësimit kombëtar, të pavarur, Komisioni i Përbashkët Shqipëri- Kosovë, për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik (këtej e në vijim Komisioni) do të arrijë në një konsensus për përzgjedhjen e 10 projekteve fituese.

Për këtë përzgjedhje, Komisioni do të bazohet në rezultatet e nxjerra prej ekspertëve të vlerësimit të secilit vend, dhe bisedave gjatë mbledhjes së Komisionit të Përbashkët. Rezultatet e takimit të përzgjedhjes së projekteve do të shpallen pas mbledhjes së Komisionit të Përbashkët dhe financimi do të kryhet pas nënshkrimit të kontratave përkatëse.

Neni 6 Financimi I Projekteve

Në total Komisioni do të përzgjedhë 10 projekte fituese .

Kohëzgjatja e një projekti shkencor do të jetë 24 muaj.

Secili vend do të subvencionojë angazhimin në projekt të kërkuesve që vijnë nga ai vend, në masën maksimale 3000 EUR në vit për cdo projekt fitues.

Pagesa do të kryhet në monedhën vendase, në masë të barasvlefshme me shumën e kërkuar pa kaluar kufirin maksimal të financimit, duke iu referuar kursit të këmbimit në momentin e financimit.

Mbështetja e dhënë nga Palët për grupet e kërkimit duhet të plotësojë burimet e duhura për çdo grup dhe ka për qëllim të subvencionojë kostot e përgjithshme që lidhen me natyrën ndërkombëtare të projekteve, shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar (kryesisht transportin dhe shpenzimet për dietat ditore). Çdo grup kërkimor mund të aplikojë për mbështetje shtesë nga institucionet e tjera. Vendet financuese e ruajne të drejtën që në bazë të rregullativave ligjore të secilit vend të përcaktojnë kushtet specifike të financimit.

Kontratat do të nënshkruhen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse të secilit vend.

Financimi do të përballohet nga pala dërguese.

Neni 7

Sigurimi Shëndetësor

Vizitori duhet të ketë sigurim shëndetësor që i jep të drejtën mbajtësit të përfitojë trajtim mjekësor falas për raste urgjencash shëndetësore në vendin pritës. Përgjegjësia për ofrimin e një sigurimi shëndetësor të përshtatshëm në raste të aksidenteve që mund të ndodhin gjatë qëndrimit në vendin pritës do të ndahet me palën dërguese.

Pala pritëse do t'i sigurojë vizitorit asistencë organizative të domosdoshme në situata që kërkojnë ndërmarrjen e hapave të tillë.

Neni 8

Pronësia intelektuale

Kërkuesit e secilit vend duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar mbrojtjen e pronës intelektuale që do të mundë të rezultojë nga projektet e përbashkëta të kërkimit.

Neni 9

Afati i aplikimeve

Thirrja do të hapet në datë 15 maj 2019 dhe do të mbyllet në datë 15 gusht 2019.

Neni 10

Dispozita përfundimtare


Kjo marrëveshje hyn në fuqi më nënshkrimin e saj, datë 7 maj 2019.

Ndryshimet në këtë marrëveshje mund të propozohen nga palët nënshkruese.

Ndryshimet e propozuara do të marrin formë të prerë pasi palët të bien dakord reciprokisht në formë të shkruar.

Nënshkruar 4 kopje origjinale të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

Për
Agjencinë Kombëtare
të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit



Për
Ministrinë e Arsimit Shkencës
dhe Teknologjisë së
Republikës së Kosovës



